

Vendim nr. 68 datë 04.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 04.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “BANKERS PETROLEUM ALBANIA” LTD.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit nr. 172, datë 06.12.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Kalimi i çështjes në seancë plenare.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 1, 50, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Bankers Petroleum Albania” Ltd., në datën 12.09.2022 ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-896 (150), datë 11.04.2022 të Gjykatës së Lartë, me të cilin

ishte rrëzuar përfundimisht padia e saj lidhur me rimbursimin e detyrimeve doganore për shkak të përjashtimit nga pagesa e taksave të qarkullimit dhe karbonit.

2. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 172, datë 06.12.2022 (*vendimi nr. 172/2022*), ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

3. Në datën 03.02.2023 kërkuësja i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 172/2022 dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

II

Pretendimet e kërkuëses

4. **Kërkuësja** ka pretenduar rishikimin e vendimit nr. 172/2022 në drejtim të rivlerësimit të përmbushjes së kriterit të legjitimitetit *ratione temporis*, për shkak se:

- 4.1. Ekziston një rrethanë e re, e konfirmuar pas dhënies së vendimit, sipas së cilës ankimi kushtetues i datës 12.09.2022 është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor. Vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 02.06.2022 dhe në faqen e internetit është publikuar në datën 13.06.2022.
- 4.2. Përllogaritja e saktë e afatit të paraqitjes së ankimit kushtetues individual siguron të drejtën e aksesit në gjykatë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Llogaritja e tij nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin, nëse kërkuësi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme, nuk është bazuar në ligj dhe vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), e cila e lidh afatin me dorëzimin e vendimit të kërkuësi ose marrjen dijeni nga avokati.

III

Vlerësimi i Kolegjit

5. Kolegji vëren se çdo individ, përfshi personin juridik, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

6. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr.

8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se kërkesa ka në objektin e saj rishikimin e vendimit nr. 172/2022 të dhënë nga një kolegji i mëparshëm i Gjykatës gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës. Me anë të këtij vendimi është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se kërkesja nuk kishte plotësuar një nga kriteret e pranueshmërisë për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues - atë të afatit të paraqitjes së kërkesës, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000. Pas dhënies së vendimit nr. 172/2022 të Kolegjit dhe marrjes dijeni për të, kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës duke kërkuar rishikimin e tij, me bazë ligjore nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), nën dritën e rrethanave dhe provave të reja të dala pas komunikimit të tij, bazuar në informacionet me shkrim të dhëna nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me kërkesë të saj. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka informuar kërkesen se vendimi i saj nr. 00-2022-896 (150), datë 11.04.2022 është bërë i disponueshëm për palët në datën 02.06.2022, ndërsa në faqen e internetit është publikuar në datën 13.06.2022. Ndërsa, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me shkresën e datës 23.01.2023, ka informuar se në dosjen gjyqësore nuk gjendet ndonjë provë që vendimi i Gjykatës së Lartë të jetë njoftuar me postë elektronike. Në këto kushte, kërkesja parashtron se ankimi kushtetues i saj i datës 12.09.2022, në ndryshim nga sa ka vlerësuar Kolegji i Gjykatës, duhet konsideruar se është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

8. Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkesja është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 11.04.2022, kurse ankimi kushtetues individual në atë rast, pavarësisht se mbante datën 30.08.2022, është paraqitur dorazi në Gjykatë në datën 12.09.2022. Megjithatë, kërkesja ka pretenduar se vendimi i është njoftuar në datën 30.05.2022, ajo nuk ka paraqitur ndonjë akt, bashkëlidhur ankimit kushtetues, për të provuar këtë pretendim (*shih paragrafin 4.3 të ankimit të saj*).

9. Në parantezë, Kolegji, në këndvështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, të sjellë në vëmendje edhe nga kërkesja, pohon se afati ligjor “4-mujor nga konstatimi i cenimit” llogaritet nga momenti kur individi provon marrjen dijeni të vendimit që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar prej tij. Në këtë drejtim, në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, afati 4-mujor llogaritet nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Kolegji thekson se

ndonëse aksesimi në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit, ai mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 42, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më sipër, Kolegji evidenton se shkresat e paraqitura nga kërkuesja, të cilat, në thelb, janë përgjigje që gjykatat i kanë kthyer kërkesës së saj për informacion, do të duhet të ishin paraqitur në kohën e shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues, i cili, siç u evidentua më lart, jo vetëm që tregonte një datë tjetër të marrjes së vendimit gjyqësor të kundërshtuar, por nuk shoqërohej nga ndonjë dokument provues mbi datën e njoftimit. Në këtë kuptim, Kolegji thekson se në rastin e ankimeve kushtetuese individuale, gjykimi kushtetues vihet në lëvizje nga vetë individi, që do të thotë se ai, nga njëra anë, prezumohet se është në dijeni të kriterëve paraprakë dhe jurisprudencës së Gjykatës mbi to dhe, nga ana tjetër, ka barrën e paraqitjes së akteve provuese që mbështesin pretendimet e tij, sidomos kur asistohet në procedurën e ankimit nga avokati, siç është edhe rasti i kërkueses.

11. Në vijim, Kolegji vëren se neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim individual kushtetues i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*rregullorja*), e miratuar me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndërsa KPC-ja, e referuar nga kërkuesja si bazë ligjore e kërkesës, ka në objektin e saj rregullat procedurale të gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Edhe pse neni 1, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 lejon zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, kjo është e mundur në ato raste kur çështjet lidhen me procedura që nuk rregullohen nga vetë ky ligj ose rregullorja.

12. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se neni 494 i KPC-së, i referuar nga kërkuesja, nuk është i zbatueshëm, pasi ligji nr. 8577/2000 dhe rregullorja kanë parashikuar në dispozita të posaçme për kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Konkreisht, ligji nr. 8577/2000 parashikon: (a) rihapjen e procesit gjyqësor në rast të një vendimmarrje të mëparshme të saj, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit (*neni 71/c*) dhe (b) saktësimin dhe plotësimin e vendimit, me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi

të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80*). Ky rregullim i fundit është detajuar edhe në nenin 43 të rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës Kushtetuese pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësojë, plotësojë ose ndreq gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të.

13. Nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të analizuara më lart, në raport me rrethanat dhe faktet e rastit në shqyrtim, Kolegji çmon se kërkesa nuk mund të pranohet, pasi kërkesja nuk gjendet në ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenet 71/c dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të rregullores.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuases shoqëria “Bankers Petroleum Albania” Ltd. për rishikimin e vendimit nr. 172, datë 06.12.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.